

Informacion mbi Coronavirus 20 Mars 2020

Informacione për personelin sanitar

Çfarë pasojash ka situata aktuale për personelin sanitar në shërbimin publik? Përgjigje për pyetjet më të rëndësishme

Në Zvicër ekziston një numër në rritje i rasteve me Coronavirus. Duke qenë se virusi po përhapet, kemi kufizime të mëdha në jetën e përditshme dhe në punë. Çfarë pasojash ka kjo gjë për punëmarrësit?

Mua më duhet të kujdesem për një fëmijë të sëmurë. Lejohem të qëndroj në shtëpi?

Në përgjithësi, prindërit, pasi të dorëzojnë raportin e mjekut, lejohen të marrin tre ditë leje për tu kujdesur për fëmijët e sëmurë, në spitalet publik edhe më gjatë. Nëse në këtë rast çështja e vazhdimit të pagesës së pagës nuk është saktësuar në kontratën e punës, kujdesi për fëmijët e sëmurë trajtohet si një paaftësi për të punuar në përputhje me OR 324a, pra një paaftësi për të punuar, pa qenë i sëmurë vetë. Punëdhënësi është gjithashtu i detyruar, të paguaj pagën në përputhje me këtë gjë.

Pavarësisht pagesës, prindërit mund të qëndrojnë edhe më gjatë në shtëpi për tu kujdesur për fëmijën, nëse nuk ka një zgjidhje tjetër. Atëherë ata normalisht nuk do të marrin pagë.

Por në rastin e një pandemie me rrezik të madh infektimi nuk ka kuptim, që pasi të jenë kujdesur për një person të sëmurë, të kthehen përsëri në punë pas tre ditësh dhe të infektojnë njerëz të tjerë. **Prandaj VPOD kërkon në këtë rast, që paga të vazhdojë të paguhet edhe përtej afatit prej 3 ditësh.**

Kopshti ose shkolla e fëmijëve të mi u mbyll dhe unë nuk kam askënd, i cili mund të kujdeset për to. Lejohem të qëndroj në shtëpi?

Që prindërit të kujdesen për fëmijët e tyre është një detyrim ligjor (Neni 276 ZGB). Nëse punëmarrësit pengohen për një arsye të tillë që të shkojnë në punë, punëdhënësi është i detyruar që të vazhdojë t'i paguajë atyre pagën, në përputhje me nenin 324a OR. Por prindërit duhet të kujdesen, që të evitojnë mungesa të tjera duke kryer një organizim të përshtatshëm.

Por në rastin e një pandemie nuk ka kuptim, që të organizohen forma të tjera të kujdesit kolektiv (për shembull, kujdes i përbashkët me prindër të tjerë). **Prandaj VPOD kërkon që paga në këtë rast të vazhdojë të paguhet për periudhën kohore që kopshti ose shkolla është e mbyllur.**

Unë punoj me kohë të plotë në pastrimin e spitalit dhe më është kërkuar që të punoj edhe jashtë orarit. Lejohet që punëdhënësi të kërkojë një gjë të tillë?

Punëmarrësit, në raste përjashtimore, mund të detyrohen të kryejnë orë shtesë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme (Neni 321c Pika 1 OR):

1. Domosdoshmëria: Orët shtesë duhet të jenë të domosdoshme, sepse për shembull ka shumë punë ose punët janë urgjente.
2. Nuk ka mbingarkesë të punës fizike dhe mendore të punëmarrësit: Kryerja e orëve shtesë nuk lejohet të ketë si pasojë mbingarkesë mendore dhe fizike në performancën e punëmarrësit.
3. Arsyetimi: Orët shtesë duhet t'i akordohen punonjësit me besimin dhe arsyetimin që ai është i aftë t'i kryejë ato. Në rastin e punëmarrësve me kohë të pjesshme, i duhet kushtuar vëmendje vlerësimit të arsytimit, pasi ata përveç punës me kohë të pjesshme, mund të kenë edhe përgjegjësi të tjera për përkujdesje. Vetëm atëherë mund të themi që kemi të bëjmë më orë shtesë.
4. Respektimi i përcaktimeve të ligjit të punës (ArG) mbi oraret e punës dhe të pushimit.

Unë punoj me pagesë në bazë të orëve të punës dhe/ose me kohë të pjesshme në pastrimin e spitalit. Mund të më kërkohej të bëj orë shtesë?

Po, i njëjti rregull si më lart vlen edhe për punonjësit me kohë të pjesshme ose për punonjësit që paguhet për orë pune. Por siç thamë: kush ka detyrime përkujdesi ose kush e ka të përcaktuar me ditë fikse në kontratën punës për arsye planifikimi për shkak të detyrimeve familjare, këtyre personave nuk i duhet kërkuar që të kryejnë punë shtesë.

Unë punoj në pastrimin e spitalit dhe kam frikë se mund të infektohem me virus. A mund ta refuzoj punën?

Jo. Sidoqoftë, punëdhënësi duhet t'ju pajisë në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme për çdo punë, në raste të tilla në spital ne kërkojmë të njëjtat kushte si ato të personelit mjekësor. Sidomos personeli sanitar, që pastron në pavionet e izolimit, duhet të jetë i pajisur mjaftueshëm me pajisje dhe maska mbrojtëse për fytyrën.

Për më tepër VPOD kërkon, që personat mbi 60 vjeç dhe personat me sëmundje të mëparshme, nuk lejohet të punojnë dhe të pastrojnë në pavionet e izolimit dhe orët maksimale javor të punës nuk lejohet të tejkalohen.